



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P 750/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.11.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Modifikimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-31551-10-26-2017, me objekt : “*Prodhim të dokumentacionit specifik (karta rezidenti)*”, me fond limit 10,335,600 lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar më datë 20.11.2017 nga autoriteti kontraktor, Tirana Parking.

Ankimues:

“Adel Co” shpk
Rruga “Muhamet Gjollesha” Zogu i Zi Tiranë.

Autoriteti Kontraktor

Tirana Parking
Rruga Ali Begeja, Nd 16, kodi postar 1017, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.914 datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për Miratimin e Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.



II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04.08.2017 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-31551-10-26-2017, me objekt : “Prodhim të dokumentacionit specifik (karta rezidenti)”, me fond limit 10,335,600 lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar më datë 20.11.2017 nga autoriteti kontraktor, Tirana Parking.

II.2. Në datën 09.08.2017 operatori ekonomik “Adel CO” sh.p.k, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit me argumentat si më poshtë:

[...]

Shoqëria “Adel co” shpk u njoh me dokumentat e tenderit me objektin e mësipërm më datë 27.10.2017 nëpërmjet sistemit të APMP-së. Nga shqyrtimi i dst-ve mendojmë se pika e kriterëve të vecanta për kualifikim janë hartuar në kundërshtim me LPP-në më konkretisht:

1. Në dst në kapaciteti teknik teknik pika 2.3.2 parashikohet: Ofertuesit duhet te paraqesin prane Autoritetit Kontraktor Tirana Parking, ne daten dhe oren e hapjes se ofertave, mostra te kartave te rezidentit, **8 (tetë) cope**, ne perputhje me te gjitha specifikimet teknike ne DST, sipas formularit tip. Mosparaqitja e mostrave perben kusht s'kualifikimi.

Referuar përcaktimit të bërë në dst ne mendojmë që ky kriter është i paqartë dhe në kundësthim me LPP-në. Në legjislacionin e prokurimit publik përcaktohet që kriteret për kualifikim të hartohen nga autoritetet kontraktore duhet të jenë të qarta dhe të përcaktojnë shprehimisht çfarë kërkohet.

Në sistemin e prokurimit elektronik ju keni ngarkuar një file (dokument), i cili përmban të njëjtat të dhëna me ndryshime në disa elementë. Gjithsej janë 4 imazhetë ndryshme të ngarkuara në një dokument të vetëm. Përsa më sipërju lutem përcaktoni nëse oe-të pjesëmarrës në këtë procedurë do të dorëzojnë 8 modele kartash rezidenti në tërësi (pra dy copë për secilën zonë), apo nga 8 (copë) për secilën zonë parkimi dhe në total janë 32 copë.

Ju lutem saktësimin dhe modifikimin e këtij kriteri pasi përcaktimi i tij në dst krijon konfuzion për oe-të potencialë për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi dhe kjo bën ndesh me LPP-në.

Në specifikimet teknike në dst është përcaktuar që malli që prokurohet do të ketë edhe elementë sigurie “Hologramë e personalizuar 3D me logon e Bashkisë”. Referuar këtij përcaktimi ju duhet të modifikoni kriterin e mësipërm dhe të kërkonit në ditën e hapjes së ofertave të paraqiten mostra të ngjashme dhe jo identike me objektin që prokurohet.

Ju bëjmë me dije se përcaktimi i këtij kriteri në dst është në kundësthim të hapur me ligjin. Një operator ekonomik nuk mund të shtypë një hologram të personalizuar identike me modelin e kërkuar nga AK-ja pa marrë miratimin me shkrim dhe dizajnin nga vet ak-ja. Për nga rëndësia dhe nga elementët sekretë që përmban një hologramë materiali identik për shtyp i jepet vetëm operatorit ekonomik fitues të kontratës, dhe në kontratë përcaktohen më pas të gjitha kufizimet dhe kujdesi në prodhimin e hologramës. Pra autoriteti juaj kontraktor duhet të kërkojë një model me hologramë të ngjashme që të përmbajë elementët sekretë të kërkuara nga AK-ja por jo një hologramë identike të personalizuar pasi përbën shkelje ligjore prodhimi i një holograme pa miratimin e Autoritetit Kontraktor.

Pra këtë pullë holografike mund ta prodhojë vetëm firma që e ka pasur së fundmi bashkëpunim me Autoritetin tuaj Kontraktor. Ibëjmë me dije AK-së se sipas rregullave për prodhimin e hologramës duhet një dizajn i kësaj holograme, elementët e kësaj holograme miratimin e provokopjes së kësaj holograme, por edhe regjistrimin e së drejtës së autorit të kësaj holograme, rregulla shumë të forta që asnjë kompani që prodhon hologramën nuk e realizon pa pasur një vërtetim me shkrim nga enti që porosit hologramën. Ju bëjmë me dije se AK-ja ka mungesë informacioni mbi këtë proces pasi vetëm përgatitja e kallëpeve të hologramës kushton 10.000 euro edhe në eksperiencën tonë është hera e parë që një institucion shtetëror kërkon hologramën identike pasi çënohet rëndë barazia në tender.

Referojmë VKM-në 914 neni 27 pika 6[.], si dhe LPP-në. Pra AK-ja duhet të kërkojë një mostër të ngjashme që të jetë në përmbajtje disa prej elementëve të specifikimeve teknike, në mënyrë që të krijojnë bindjen se një operator ekonomik i zotëron kapacitet për të prodhuar hologramën dhe jo një mostër identike pasi çënon në këtë rast parime të rëndësishme të saksionuara nga LPP-ja si parimin e barazisë, të mosdiskriminimit, Pra përsa më sipër nuk mund të prodhohet holograma identike, për këtë arsye kërkojmë që nga AK-ja, holograma identike të zëvendësohet me hologramë të ngjashme që të plotësojë elementët e hologramës si më sipër.

Përsa thamë më lart duke pasur parasysh LPP-në dhe RRPP-në fryma që përcjell ky ligj për modelet e ngjashme është që AK-ja të krijojë bindjen se një oe i ka kapacitet për të prodhuar

objektin e kontratës që prokurohet, dhe oe-të të paraqesin modele të ngjashme me elementët e specifikimeve teknike të përcaktuara në dst (pasi nuk është dhënë as dizajni dhe as specifikimet e kësaj holograme).

Përsa më sipër këtrkojmë modifikimin e këtij kriterei pasi është në kundërshtim me ligjin.

2. Në dst në kapacitetin teknik pika 2.3.3. përcaktohet: Ofertuesi duhet te kete ne zoterim certifikaten **ISO 9001:2008** mbi “Sistemet e menaxhimit te cilesise”, **në përputhje me objektin e prokurimit**, leshuar nga institucionet zyrtare te akredituar per kete qellim. Certifikata kerkohet te jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit, si dhe te kete si qellim objektin e procedures. Ne rast e bashkimit te operatorit ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikaten ISO.

Ky kriter është në kundërshtim me LPP-në. Më poshtë do të gjeni argumentimin tonë të bazuar në LPP.

Referojmë VKM-në 914 RRPP neni 30[...], si dhe nenin 23 pika 3 nënpikën c të LPP-së[...]

Në kriterin e përcaktuar nga ju në dst nuk është përcaktuar fjala “ekujvalent i tij/saj” dhe kjo është në kundërshtim me paarsimet ligjore. Arsyja pse legjislatori e ka parashikuar këtë togfjalësh është pasi standartet ndërkombëtare evulojnë dhe përditësohen vazhdimisht dhe në një kohë të shpejtë sic është dhe rasti i kësaj certifikate të kërkuar nga autoriteti juaj kontraktor.

Rasti i kësaj certifikate është pikërisht një nga ato rastet e përditësimit të këtyre certifikimeve Standarti ISO 9001:2008 është përditësuar me standartin ISO 9001:2015. pRa vet organizata e certifikimeve ISO nuk ofron më certifikim ISO 9001:2008. Ky kriter duhet të modifikohet nga autoriteti juaj kontraktor në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik dhe të shtohet togfjalëshi ekuivalenti tij/saj”.

Në lidhje me togfjalëshin “si dhe të ketë si qëllim objektin e procedurës” theksojmë se është i paqartë dhe krijon konfuzion për oe-të potencialë për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi pasi një certifikim ndërkombëtar nuk mund të ketë kurrësi si qëllim objektin e procedurës së prokurimit. Një certifikim ndërkombëtar mund të jetë i ngjashëm me objektin e kontratës që prokurohet por jo që të ketë si qëllim objektin e procedurës. Qëllimi për certifikimin me standarte ndërkombëtare është përshtatja e standarteve të prodhimit cilësisë apo standarteve të tjera me ato ndërkombëtare. E njëjta gjë edhe me certifikatën ISO14001:2004 duhet të modifikohet dhe të shtohet togfjalëshi ekuivalenti i tij/saj.

Për sa m'ësi [për ju lutemi modifikimin e këtij kriterei pasi është i paqartë dhe në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik.

3. Në dst në kapacitetin teknik pika 2.3.4. përcaktohet se: Ofertuesi duhet te kete ne zoterim certifikaten **ISO 14298:2013** mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së printimit”, në përputhje me objektin e prokurimit, leshuar nga institucionet zyrtare te akredituar per kete qellim. Certifikata kerkohet te jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit. Ne rast e bashkimit te operatorit ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikaten ISO.

Në lidhje me këtë kriter qëndron i njëjti argumentim i bërë në kriterin e mësipërm pasi autoriteti juaj kontraktor sërish nuk përcakton togfjalëshin ekuivalenti i tij/saj.

Për sa më sipër ju lutem modifikimin e këtij kriterei sipas argumentimit më sipër pasi përcaktimi i tij në dst është në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin public.

4. Në dst në kapacitetin teknik pika 2.3.5. përcaktohet se: Ofertuesi duhet te kete ne dispozicion makinerite e meposhtme:

- a) Shtypi offset me minimalisht 4 ngjyra dhe minimalisht format 50x70cm, (1 cope)
- b) Pajisje pergatitore per shtyp CTP, (1 cope)
- c) Pajisje plastifikimi, (1 cope)
- d) Pajisje prerje me forme me format minimal 50x70cm, (1 cope)
- e) Pajisje per numerator dhe perforcim, (1 cope)

Per te vertetuar disponueshmerine e pajisjeve, ofertuesit duhet te paraqesin fature blerje ose kontrate qeraje te shoqeruar me faturen e blerjes.

Në lidhje me kriterin si më sipër ju bëjmë me dije se është në kundërshtim me dst dhe LPP-në. Kjo kërkesë nuk është proporcionale dhe nuk i shërben procedurës së prokurimit konkrete dhe qartazi është vendosur si pengesë për oe-të potencialë për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi. Në lidhje me makinerinë e parë që kërkohet pra "Shtypi offset me minimalisht 4 ngjyra dhe minimalisht format 50x70cm, (1 cope)"ju bëjmë me dije si më poshtë:

Në specifikimet teknike të mallrave sasisë dhe grafikut të lëvrimit të përcaktuar në dst përcaktohen specifikimet teknike të mallit që prokurohet. Ndër specifikimet e tjera përcaktohet dhe formati (madhësia në cm)e mallit "formulari i kartës së rezidentit" dhe formati maksimal i kërkuar është formati A4 (21x29.7cm), ndërkohë ju kërkon makinë shtypi offset me format 50x70cm.

Pra referuar specifikimeve teknike në dst mallrat që prokurohen nga autoriteti juaj mund të shtypen dhe realizohen me një makineri me format minimal 22x31cm. Pra ky kriter i vendosur nga autoriteti juaj kontraktor nuk i shërben kësaj procedure prokurimi dhe është në tejkalim të kontratës që prokurohet.

Në lidhje me formatin e makinerive ka dhe praktikë të institucionit më të lartë vendimmarrës në fushën e prokurimeve KPP-së më konkretisht venimi nr. 197/2017 datë 05.04.2017që është dhënë për modifikimin e kriterëve [...]

Referuar sasisë dhe grafikut të lëvrimit sic dhe ju e keni shprehur formati maksimal është formati 21x29.7cm ky kriter nuk është proporcional me objektin e kontratës që prokurohet për pasojë duhet të modifikohet në përputhje me objektin e kontratës që prokurohet. Gjithashtu i njëjti argumentim është dhe për pikën d) të kriterit të mësipërm. Në kushtet që përmasat e kartës së rezidentit janë me diametër 8cm është në tejkalim të cdo parashikimi ligjor nga ana e ak-së përcaktimi në dst i një pajisjeje me formë prerje me minimum 50x70cm. Për më tepër ky kriter duhet të hiqet nga autoriteti juaj kontraktor pasi me teknologjinë e ditëve të sotme ku makineritë tashmë janë automatike dhe jo manuale procedura e prerjes me formë është një proces që është i inkorporuar në shumë makineri dhe bëhet sëbashku me procese të tjera punësh njëherësh. Pra ky proces nuk është një proces pune që kryhet në një makineri më vete, por është i inkorporuar dhe realizohet nga shumë makineri të tjera që mund të disponojë një oe.

Pra ky kriter nuk është proporcional dhe nuk shërben kontratës që prokurohet dhe për pasojë duhet të hiqet nga dst-të.

Në lidhje me pikën e) të këtij kriteri "Pajisje për numerator dhe performancë, (1 cope)", së pari na sqaroni nëse në këtë kriter kërkon një makineri apo 2 makineri pasi është një kërkesë e paqartë dhe evazive.

Gjithashtu ju lutemi sqarimin tuaj se çfarë është pajisja për performancë dhe si i shërben kësaj procedure prokurimi pasi për oet-potencialë për të marrë pjesë në këtë procedurë ky kriter është i paqartë dhe evaziv. Referojmë nën 61 pikë 2 e vkm-së RRpp[...]. Duke ju referuar kësaj baze ligjore dhe një analizë të thjeshtë të këtyre kriterëve duket qartë se AK-ja e ka shkelur haptazi këtë përcaktim ligjor pasi njësisia e prokurimit që ka hartuar keto kritere nuk ka aspak informacion apo kapacitet për të hartuar kritere në fushën e objektit që prokurohet. Në një analizë që bëhet edhe nga një person me njohuri mesatare duket qartë që këto makineri janë kërkuar nga AK-ja në shkelje të ligjit.

Gjithashtu në këtë pikë ju keni përcaktuar : "Për të vertetuar disponueshmërinë e pajisjeve, ofertuesit duhet të paraqesin fature blerje ose kontrate qeraje të shoqëruar me faturën e blerjes."

Ky kriter është shumë taksativ dhe në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik pasi i kufizon oet-potencialë për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, pasi në cdo rast ka përcaktuar që disponimi i këtyre makinerive të vërtetohet me anë të faturave të blerjes. Referuar legjislacionit të fushës ekonomike mardhëniet tregtare të subjekteve shqiptare mund të jenë brenda ose jashtë vendit. Pra një subjekt në rastin tonë një subjekt juridik mund të blejë mallra dhe shërbime si brenda ashtu dhe jashtë vendit. Në rastin e blerjes së mallrave jashtë Shqipërisë dëshmia e blerjes së këtij malli është deklarata e zhdoganimit të mallit. Në kriterin e vendosur nga ana juaj duke qënë se nuk lini mundësi që oet-potencialë të provojnë me anë të deklaratave të zhdoganimit disponimin e një malli ju diskriminoni në mënyrë direkte mallrat e blerë jashtë vendit. Në rastin e blerjes së mallrave jashtë Shqipërisë dhe kjo është në kundërshtim me frymën që përcjell LPP-ja.

Përsa më sipër kërkojmë modifikimin e këtij kriteri në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përcaktimin e deklaratave të zhdoganimit si dokument vërtetues mbi disponimin e makinerive pasi ky kriter është në kundërshtim me LPP-në.

5. Në specifikimet teknike pjesë e dst-ve ju keni përcaktuar: " Ngjyra formulari: 4 nga të dyja anët"

Referuar specifikimeve teknike formulari do të jetë i shtypur në të dyja anët ndërkohë në file –n(dokumentin)e ngarkuar nga ju në spe ky file është dhënë vetëm për shtypjen e një ane. Ju lutem saktësimin në lidhje me këtë pikë dhe sqarimin tuaj në lidhje me specifikimet e objektit që prokurohet.

Referojmë nën 46 pikë 1 gërma b) e LPP-së[...]; nën 27 pikë 3 të VKM-së RrPP-së[...]

Për sa më sipër ju lutemi modifikimin e dst-ve në lidhje me kriteret si më sipër pasi përcaktimi i tyre është bërë në kundërshtim me LPP-në.

II.3. Në datën 08.11.2017, nëpërmjet shkresës nr. 1353/3 prot., datë 06.11.2017, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, me argumentat si më poshtë vijon:

[...]

Arsyetimi për pretendimin e parë:

Lidhur me pretendimin e parë të ankimesit pas shqyrtimit të kriterëve të vecanta të kualifikimit të përcaktuara nga AK-ja, KSHA-ja arsyeton se:

Në shtojcën 10 të DST-ve 2.3. Kapaciteti teknik 2.3.2.

Ofertuesit duhet të paraqesin prane Autoritetit Kontraktor Tirana Parking, në datën dhe orën e hapjes së ofertave, mostra të kartave të rezidentit, 8 (tetë) cope, në përputhje me të gjitha specifikimet teknike në DST, sipas formularit tip. Mosparaqitja e mostrave përben kusht s'kualifikimi.

Mostrat do të testohen në pajisjet e ndodhura në ambientet e Tirana Parking. Moskalimi me sukses i testimit është kusht s'kualifikues.

Kriteri i mësipërm është vendosur duke u bazuar në nenin 27 pika 6 gërma a) të VKM-së nr. 914 RrPP-së [...] Nenin 46 pika 1 e LPP-së [...]

Referur legjislacionit të mësipërm si dhe natyrës së kontratës publike objekt i procedurës së prokurimit objekt ankimi, përmban prodhimin e dokumentacionit specifik (Karta Rezident) për autoritetin kontraktor Tirana Parking. Paraqitja e mostrave i shërben AK-së për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitet për të prodhuar produktin e kërkuar. Qëllimi i AK-së është furnizimi i produktit final për të cilën autoriteti ka kërkuar dorëzimin e mostrave.

Nisur nga specifikimet teknike të parashikuara në dst ku janë 4 imazhe që do të prodhohen për kartat e rezidentit operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë nga 8 (tëtë) cope mostra 2 (dy) mostra për imazh. Theksojmë se njëra prej mostrave do të shërbejë për testim në autoritetin kontraktor ndërsa mostra tjetër nevojitet për arkivim si dhe për cdo dëmtim të mundshëm gjatë testimit të kopjes së parë.

Gjithashtu përse i përket pretendimit tuaj se holograma si elementë përbërës i mostrës duhet të jetë i ngjashëm dhe jo identik e konsiderojmë të drejtë për shkak të natyrës së produktit final të kërkuar nga autoriteti kontraktor e cila gëzon një mbrojtje të vecantë pasi përmban elementë sigurie dhe ka nevojë për marrjen e një miratimi paraprak. Ju sqarojmë se ak-ja lejon paraqitjen e mostrave në përputhje me të gjitha specifikimet e tenderit me përjashtim të hologramës e cila do të jetë e ngjashme dhe përmbajtja e saj nuk do të përbëjë kusht s'kualifikimi. Dokumenti i kërkuar në rastin konkret karta e rezidentit do të pajiset me hologramë të personalizuar 3D me logon zyrtare të Bashkisë sikundër përcaktohet në specifikimet teknike në shtojcën 10 të dst-ve nga oe-ja i shpallur fitues dhe do të ekzekutojë kontratën. Vendosja e kërkesës së hologramës me logon zyrtare të Bashkisë në specifikimet teknike është bërë e qëllim që ofertuesit të përlllogarisin koston e saktë të produktit.

Arsyetimi për pretendimin e dytë:

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës pasi u njoh me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes arsyeton se :

Në shtojcën 10 të dst-ve “Kriteret e veçanta të kualifikimit” “Kapaciteti teknik” është kërkuar që ofruesit të paraqesin certifikat si më poshtë vijon:

certifikaten ISO 9001:2008 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, në përputhje me objektin e prokurimit, leshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qellim

certifikaten ISO 14001:2004 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit”, në përputhje me objektin e prokurimit, leshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qellim.

certifikaten ISO 14298:2013 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së printimit”, në përputhje me objektin e prokurimit, leshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qellim.

Çertifikata kerkohet të jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.

Autoriteti kontraktor për vendosjen e kriterit të të mësipërm është mbështetur në nenin 46 pika 2 e LPP-së [...]dhe në vendimin nr. 914 RrPP-sëneni 300 pika 1[...]

Nëse i referohemi definicionit që ka secila prej certifikatave rezulton se çertifikatat ISO të kërkuara janë në përputhje me objektin e prokurimit.

ISO 9001:2008 është standarti më i popullarizuar dhe më i përdorur në botë për sistemet e menaxhimit të cilësisë. Referuar objektit të prokurimit nevojitet që shoqëritë pjesmarrëse të sigurojnë cilësi në ofrimin e shërbimeve dhe në kryerjen e kontratës. Theksojmë se ISO 9001:2008 është ekuivalente me ISO 9001:2015, konkretisht për “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë” oe-ja mund të paraqesë ISO 9001:2015, e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave duke mos përbërë kusht skualifikimi, duke qënë se çertifikatat ISO janë vazhdimisht në proces rinovimi.

ISO 14001:2004 është standarti më i përdorur në botë për sistemet e menaxhimit të mjedisit. Prodhimi i dokumentacionit specifik (kartat e rezidentit), përveçse kërkojnë një kapacitet me makineri kanë edhe një ndikim në mjedis për shkak të kushteve në të cilat realizohen. Për këtë arsye cdo oeduhet të jetë i çertifikuar për menaxhimin e abjentit.

Theksojmë se ISO 14001:2004 është ekivalente me ISO 14001:2015, konkretisht për “Sistemet e menaxhimit të abjentit”, oe-ja mund të paraqesë ISO 14001:2015 e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave, duke mos përbërë kusht skualifikimi, duke qënë se çertifikatat ISO janë vazhdimisht në proces rinovimi.

ISO 14298:2013 “Sistemet e menaxhimit të printimit”, është standarti më i përdorur për sistemet e menaxhimit të sigurisë së printimit, për të mundësuar realizimin cilësor të një produkti në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Theksojmë se dhe për çertifikatën e sipërpërmendur mund të paraqitet ekivaletja e saj duke mos përbërë kusht skualifikimi, duke qënë se çertifikatat ISO janë vazhdimisht në proces rinovimi.

Gjithashtu ju sqarojmë se çertifikatat ndërkombëtare ISO të lëshuara nga organe të akredituara pasqyrohet objekti i ushtrimit të aktivitetit të subjektit ofertues, sipas QKR-së. Nëse organe të ndryshme të akreditimi , përdorin mënyra të ndryshme të formulimit të çertifikatës kjo nu sjell probleme në vlerësim nga ana jonë.

Arsyetimi për pretendimin e tretë.

Lidhur me pretendimin e mësipërm KSHA-ja argumenton se:

Në shtojcën 8 të DST-ve kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik pika 2.3.5 kërkohet

2.3.5. Ofertuesi duhet të ketë në dispozicion makinerite e mëposhtme:

a) Shtypi offset me minimalisht 4 ngjyra dhe minimalisht format 50x70cm, (1 cope)

b) Pajisje përgatitore për shtyp CTP, (1 cope)

d) Pajisje prerje me forme me format minimal 50x70cm, (1 cope)

e) Pajisje për numerator dhe perforcim, (1 cope)

Për të vërtetuar disponueshmërinë e pajisjeve, ofertuesit duhet të paraqesin fature blerje ose kontratë qeraje të shoqëruar me faturën e blerjes.

Referuar nenit 46 pika 1 gërma b) e LPP-së[...]

Përsa më sipër kriteri i vendosur nga AK-ja është në mbështetje të legjislacionit të prokurimeve publike dhe në proporcion me natyrën dhe objektin e procedurës së prokurimit. Kërkesa për makineri i shërben autoritetit kontraktor për të vërtetuar se ofruesit kanë kapacitetin e nevojshëm për realizimin e kontratës. Në rastin konkret:

Makineria “Shtypi offset me minimalisht 4 ngjyra dhe minimalisht format 50x70cm, (1 cope)” është vendosur duke u bazuar nga hulumtimi në internet të tipit të pajisjes së lartpërmendur si dhe duke u mbështetur në procedura të ngjashme të realizuara me objektin e prokurimit. Format i kërkuar i makinerisë 50x70cm është vendosur në proporcion me natyrën dhe volumin e specifikimeve teknike të kërkuara më konkretisht: në specifikime janë kërkuar katër modele të ndryshëm formularësh, teknologjia e printimit të së cilave duhet të jetë shtyp offset dhe formati i letrës për makineri e këtij lloji kërkon dimension 50x70 cm (4 fletë në një tabak). Nisur kjo dhe nga afati i lëvrimit të mallit të përcaktuar në shtojcën 12 të dst-ve “Sasia dhe grafiku i lëvrimit”, prodhimi dhe furnizimi me dokumentacionin specifik (karta rezidenti) duhet të realizohet brenda 20 (njëzet) ditëve nga momenti i nënshkrimit të kontratës, për një sasi prej 162.000 formularë. Formulari i makinerisë së pretenduar nga ana juaj 22x31cm rezulton se i korrespondojnë një pajisjeje të tipit printer dhe jo makineri.

Lidhur me makinerinë “Pajisje prerje me forme me format minimal 50x70cm, (1 cope)”, argumentojmë se procesi i prerjes së formularit është i lidhur me procesin e shtypjes, që do të thotë se formati maksimal i letrës do të korrespondojë me ata të shtypit.

Karta është pjesë e integruar e formularit pra në makinerinë e prerjes nuk futet vetëm karta por i gjithë formulari plus marzhet e nevojshme teknike. Gjithashtu një format makinerie katër herë më i madh bën të mundur futjen e katër modeleve njëkohësisht për prodhimin në kohë. Vlen të theksojmë edhe në këtë pikë periudhën për realizimin e objektit të prokurimit prej 20 ditësh.

Për makinerinë “Pajisje për numerator dhe perforcim, (1 cope)” ju sqarojmë se për përmbushjen e këtij kriteri mund të paraqitet edhe një makineri për realizimin e këtyre dy proceseve: numerator dhe perforcim.

Lidhur me pretendimin tuaj për dokumentat për disponimin e makinerive , siç janë faturë blerje ose kontratë qirajetë shoqëruar me faturën e blerjes, ju sqarojmë se pajisjet e importuara shoqërohen gjithmonë me deklaratën doganore dhe faturën e blerjes së makinerisë.

Arsyetimi për pretendimin e katërt:

Përsa i përket pretendimit të mësipërm Komisioni arsyeton se:

Specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 10të dst-ve janë vendosur në përputhje me produktin përfundimtar të objektit të prokurimit, i cili do të jetë në të dyja anët. Ju sqarojmë se në pjesën e pasme të kartës do të jenë të vendosura instruksionet e nevojshme për mënyrën e përdorimit të produktit final. Vlen të përmendim se dokumenti i ngarkuar në spe nuk është ai final pasi imazhi përfundimtar i kartës së rezidentit do ti jepet oe-së që do të shpallet fitues.

Përfundimet:

Përfundimisht referur edhe të gjithë arsyetimit të dhënë më sipër, respektivisht për cdo pretendim të oe-së mendojmë se pretendimet nuk janë në mbështetje dhe në përputhje me VKM-në dhe LPP-në i ndryshuar, rrjedhimisht pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Adel Co" shpk të parashtruara në ankesën 1353Prot., datë 01.11.2017 nuk qëndrojnë.

II.4. Në datën 15.11.2017 pala ankimuese "Adel Co" sh.p.k., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me argumentat si më poshtë vijon:

[...]

Më datën 08.11.2017 njihemi me përgjigjen e autoritetit kontraktor me anë të shkresës nr. 1353/3 datë 06.11.2017, përgjigje me anë të së cilës na komunikohet se ankesa jonë nuk është marrë parasysh nga autoriteti kontraktor. Referojmë nenin 19/1 të LPP-së , referuar këtij parashikimi ligjor po ju drejtohem me pretendimet tona si më poshtë vijon:

Në dst në kapacitetin teknik pika 2.3.5. përcaktohet se: Ofertuesi duhet te kete ne dispozicion makinerite e meposhtme:

- a) Shtypi offset me minimalisht 4 ngjyra dhe minimalisht format 50x70cm, (1 cope)*
- b) Pajisje pergatitore per shtyp CTP, (1 cope)*
- c) Pajisje plastifikimi, (1 cope)*
- d) Pajisje prerje me forme me format minimal 50x70cm, (1 cope)*
- e) Pajisje per numerator dhe perforcim, (1 cope)*

Per te vertetuar disponueshmerine e pajisjeve, ofertuesit duhet te paraqesin fature blerje ose kontrate qeraje te shoqeruar me faturen e blerjes.

Në lidhje me kriterin si më sipër ju bëjmë me dije se është në kundërshtim me DST-të dhe me legjislacionin e prokurimit publik. Kjo kërkesë nuk është proporcionale dhe nuk i shërben procedurës së prokurimit konkrete dhe qartazi është vendosur si pengesë për oe-të potencialë për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi. Në lidhje me makinerinë e parë që kërkohet pra "Shtypi

offset me minimalisht 4 ngjyra dhe minimalisht format 50x70cm, (1 cope)” ju ëjmë me dije si më poshtë vijon:

Në specifikimet teknike të mallrave sasisë dhe grafikut të lëvrimit të përcaktuar në dst përcaktohen specifikimet teknike të mallit që prokurohet. Ndër specifikimet e tjera përcaktohet dhe formati (madhësia në cm) e mallit ”formulari i kartës së rezidentit” dhe formati maksimal i kërkuar është formati A4 (21x29.7cm), ndërkohë ju kërkon makinë shtypi offset me format 50x70cm.

Pra referuar specifikimeve teknike në dst mallrat që prokurohen nga autoriteti juaj mund të shtypen dhe realizohen me një makineri me format minimal 22x31cm. Pra ky kriter i vendosur nga autoriteti juaj kontraktor nuk i shërben kësaj procedure prokurimi dhe është në tejkalim të kontratës që prokurohet dhe për më tepër është taksativ.

Në lidhje me formatin e makinerive ka dhe praktikë të institucionit më të lartë vendimmarrës në fushën e prokurimeve KPP-së më konkretisht venimi nr. 197/2017 datë 05.04.2017 që është dhënë për modifikimin e kriteve [...]

Referuar sasisë dhe grafikut të lëvrimit sic dhe ju e keni shprehur formati maksimal është formati 21x29.7cm ky kriter nuk është proporcional me objektin e kontratës që prokurohet për pasojë duhet të modifikohet në përputhje me objektin e kontratës që prokurohet.

Referuar pretendimit të autoritetit kontraktor se Makineria “Shtypi offset me minimalisht 4 ngjyra dhe minimalisht format 50x70cm, (1 cope)” është vendosur duke u bazuar nga hulumtimi në internet të tipit të pajisjes së lartëpërmendur si dhe duke u mbështetur në procedura të ngjashme të realizuara me objektin e prokurimit. Format i kërkuar i makinerisë 50x70cm është vendosur në proporcion me natyrën dhe volumnin e specifikimeve teknike të kërkuara më konkretisht: në specifikime janë kërkuar katër modele të ndryshëm formularësh, teknologjia e printimit të së cilave duhet të jetë shtyp offset dhe formati i letrës për makineri e këtij lloji kërkon dimension 50x70 cm (4 fletë në një tabak). Nisur kjo dhe nga afati i lëvrimit të mallit të përcaktuar në shtojcën 12 të dst-ve “Sasia dhe grafiku i lëvrimit”, prodhimi dhe furnizimi me dokumentacionin specifik (karta rezidenti) duhet të realizohet brenda 20(njëzet) ditëve nga momenti i nënshkrimit të kontratës, për një sasi prej 162.000 formularë. Formulari i makinerisë së pretenduar nga ana juaj 22x31cm rezulton se i korresponon një pajisjeje të tipit printer dhe jo makineri. Shoqëria “Adel Co” shpk argumenton si më poshtë vijon:

Së pari autoritetet kontraktore në hartimin e keitereve të vecanta për kualifikim nuk duhet të bazohen vetëm në hulumtimet në internet, apo procedura të ngjashme me objektin e prokurimit, pasi në legjislacionin e prokurimit publik më konkretisht, referojmë në nenin 61 pika 2 e vkm-së 914 datë 29.12.2014 RrPP i ndryshuar [...].

Pra referuar bazës ligjore të mësipërme duket qartë që legjislatori nuk ka lënë vend për interpretim për këtë pikë në mënyrë që autoritet kontraktore mos të përfitojnë nga kompetencat e dhëna nga ligji gjatë prokurimit të fondeve publike. Në rastin e këtij kriteri të vendosur nga AK-ja duket qartë që këto kriterë nuk janë hartuar nga struktura të specializuara në fushën e objektit që prokurohet. Më konkretisht:

Në sasinë dhe grafikun e lëvrimit parashikohet që malli që prokurohet do të ketë format A4 dhe do të jetë në sasi 162.000 formularë. Karakteristikë e shtypshkronjave është që kanë makineri shtypi automatike të teknologjive të fundit. Sic edhe dihet këto makineri shtypin me një shpejtësi me minimumi 10.000 në orë. Duke marrë si referencë shpejtësinë minimale të shtypit sasia e prokuruar

nga ak-ja (e llogaritur vetëm një fletë në një tabak) shtypet për vetëm 17 orë). Pra sic mund të konkludohet kërkesa e ak-së është në tejkalim të qëllimit të ak-së për realizimin me sukses të objektit të kontratës që prokurohet.

Në rastin konkret AK-ja mund të kërkojë edhe një makineri me format 35x52cm që lejon llogaritjen dhe shtypjen e 2 formularëve në një tabak dhe realizimi i gjithë procesit të shtypit për 9 orë.

Kriteri si më sipër i vendosur nga ak-a mbi formatin e makinerisë është joproportional por edhe diskri minues, pasi ky kriter diskriinon dhe kufizon pjesmarrjen e biznesit të vogël në këtë procedurë prokurimi, parim ky i mbrojtur dhe i saksionuar nga LPP-ja.

Referojmë nenin 46 pika 3 [...]

Pra sa më sipër malli që prokurohet nga ak-ja mund të realizohet edhe me makineri të tjera që janë në proporcion me objektin e prokurimit dhe që garantojnë bazarizxë pjesmarrjen dhe konkurrencën në procedurën e prokurimit konkrete.

Gjithashtu i njëjti argumentim është edhe për pikën d) të kriterit të mësipërm. Në kushtet që përmasat e kartës së rezidentit janë me diametër 8 cm, është në tejkalim të cdo parashikimi ligjor nga ana e ak-së përcaktimi në dst i një pajisjeje me formë prerje minimum 50x70cm. Për më tepër ky kriter duhet të hiqet nga ak-ja pasi me teknologjinë e ditëve të sotme, ku makineritë tashmë janë automatike dhe jo manuale procedura e prerjes me formë është një proces që është i inkorporuar në shumë makineri dhe bëhet sëbashku me procese të tjera pune njëherësh. Pra ky proces nuk është më një proces pune që kryhet në një makineri më vete, por është i inkorporuar dhe realizohet nga shumë makineri të tjera që mund të disponojë një operator ekonomik.

Pra ky kriter nuk është proporcional dhe nuk i shërben kontratës që prokurohet dhe për pasojë duhet të hiqet nga dokumentat e tenderit.

Në lidhje me pikën e) të këtij kriteri “Pajisje per numerator dhe perforcim, (1 cope)”, së pari theksojmë se edhe pas sqarimit të ak-së në përgjigjen e dërguar sërish është një kërkesë e paqartë dhe evazive. Bazuar në eksperiencën tonë shumë vjecare në këtë fushë ju bëjmë me dije se nuk ekziston makineri e vetme që të realizojë të dyja proceset pra numerator dhe përforcim.

Për më tepër AK-ja nuk ka sqarë cfarë është pajisja për përforcim (apo perforcim) dhe si i shërben kësaj procedure prokurimi pasi për oe-të potencialë për të marrë pjesë në këtë procedurë ky kriter është i paqartë dhe evaziv.

Referuar LPP-së, dst-ve duhet të jenë në gjuhën shqipe, duhet të jenë të qarta dhe lehtësisht të kuptueshme dhe nga personat me aftësi të kuafizuara. Edhe vetë ak-ja nuk di se cfarë është kjo makineri përforcimi dhe përse shërben për këtë procedurë prokurimi.

Nëse këto kriteret do të ishin hartuar nga specialistë të fushës do të ishte më e qartë për ak-në që nuk ekziston një makineri e vetme që të kryejë numëror dhe përforcim.

Kemi dyshime se ak-ja ka dashur të përcaktojë “Makineri perforcim”, termi në shqip për këtë makineri është për makineri për birosje. Edhe nëse ka qënë ky qëllimi i ak-së theksojmë se sërish kjo makineri nuk i shërben kësaj procedure prokurimi pasi asnjë element i mallit që prokurohet nuk është me birosje. Prerja e kartës do të bëhet në formë prerje dhe nuk ka vend për procesin e birosjes në asnjë prej proceseve të punës deri në realizimin e produktit përfundimtar.

Duke u bazuar në një analizë të thjeshtë të këtyre kriterëve duket qartë se ak-ja ka shkelur haptazi përcaktimet ligjore , pasi njësia e prokurimit që ka hartuar këto kriterë nuk ka informacion apo kapacitet për të hartuar kriterë në fushën e objektit që prokurohet.

Nga një analizë që bëhet edhe nga një pëerson me njohuri mesatare duket qartë se këto makineri janë kërkuar nga AK-ja në shkelje të me ligjin.

Gjithashtu në këtë ikë AK-ja ka përcaktuar se “Për të vërtetuar disponueshmërinë e pajisjeve, ofertuesit duhet të paraqesin faturë blerje kontratë qiraje të shoqëruar me faturën e blerjes”.

Ky kriter është taksativ dhe në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, pasi i kufizon oe-të potencialë për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi pasi në cdo rast ka përcaktuar që disponimi i këtyre makinerive të vërtetohet me anë të faturave të blerjes. Referuar legjislacionit të fushës ekonomike mardhëniet tregtare të subjekteve shqiptare mund të jenë brenda ose jashtë vendit. Pra një subjekt në rastin tonë një subjekt juridik mund të blejë mallra dhe shërbime si brenda ashtu dhe jashtë vendit. Në rastin e blerjes së mallrave jashtë Shqipërisë dëshmia e blerjes së këtij malli është deklarata e zhdoganimit të mallit. Në kriterin e vendosur nga ana juaj duke qënë se nuk lini mundësi që oe-të të provojnë me anë të deklaratave të zhdoganimit disponimin e një malli ju diskriminoni në mënyrë direkte mallrat e blerë jashtë vendit. Në rastin e blerjes së mallrave jashtë Shqipërisë dhe kjo është në kundërshtim me frymën që përcjell LPP-ja.

Referuar pretendimit të ak-së që pajisjet e importuara shoqërohen gjithmonë me deklaratën doganore dhe faturën e blerjes së makinerisë theksojmë se fatura e lëshuar nga kompanitë e huaja për shitjen e një malli shërben për të zhdoganuar mallin në autoritetet doganore. Në rast se një subjekt tregon vetëm faturën e lëshuar nga një kompani e huaj, në asnjë rast nuk mund të vërtetohet nëse malli ka hyrë në shqipëri apo jo, pa paraqitur deklaratën e zhdoganimit të mallit nga subjekti. Përsa më sipër ky përcaktim duhet të modifikohet dhe të lejohet vërtetimi me anë të faturës së TVSH-së ose deklaratës së zhdoganimit.

Referojmë nenin 46 pikë 1 gërma b) e LPP-së[...]; VKM nr. 914 datë 29.12.2014 RrPP-së[...]

Referuar sa thamë më sipër lutemi gjithashtu që autoriteti kontraktor të marrë masat dhe të bëjë sqarimet e nevojshme me anë të një shtojce në dst për pikat të cilat na ka bërë sqarime në përgjigjen drejtuar shoqërisë sonë. Përsa më sipër ju lutem modifikimin e dokumentave standarte të tenderit në lidhje me kriteret si më sipër pasi përcaktimi i tyre është bërë në kundërshtim me legjislacionin e Prokurimit Publik.

II.6. Njëpërmjet shkresës nr1419prot., datë 16.11.2017 protokolluar me tonën me nr1703/2 datë 17.11.2017 me objekt “kthim përgjigje vendimit nr. 1703/1prot datë 15.11.2017[...], është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashttrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Adel Co” shpk për modifikimin e kriterit me argumentat se “Në dst në kapacitetin teknik pika 2.3.5. përcaktohet se: Ofertuesi duhet te kete ne dispozicion makinerite e meposhtme:

- a) Shtypi offset me minimalisht 4 ngjyra dhe minimalisht format 50x70cm, (1 cope)
- b) Pajisje pergatitore per shtyp CTP, (1 cope)
- c) Pajisje plastifikimi, (1 cope)
- d) Pajisje prerje me forme me format minimal 50x70cm, (1 cope)
- e) Pajisje per numerator dhe perforcim, (1 cope)

Per te vertetuar disponueshmerine e pajisjeve, ofertuesit duhet te paraqesin fature blerje ose kontrate qeraje te shoqeruar me faturen e blerjes.

Në lidhje me kriterin si më sipër ju bëjmë me dije se është në kundërshtim me DST-të dhe me legjislacionin e prokurimit publik. Kjo kërkesë nuk është proporcionale dhe nuk i shërben procedurës së prokurimit konkrete dhe qartazi është vendosur si pengesë për oe-të potencialë për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi. Në lidhje me makinerinë e parë që kërkohej pra “Shtypi offset me minimalisht 4 ngjyra dhe minimalisht format 50x70cm, (1 cope)” ju ëjmë me dije si më poshtë vijon:

Në specifikimet teknike të mallrave sasisë dhe grafikut të lëvrimit të përcaktuar në dst përcaktohen specifikimet teknike të mallit që prokurohet. Ndër specifikimet e tjera përcaktohet dhe formati (madhësia në cm) e mallit “formulari i kartës së rezidentit” dhe formati maksimal i kërkuar është formati A4 (21x29.7cm), ndërkohë ju kërkon makinë shtypi offset me format 50x70cm.

Pra referuar specifikimeve teknike në dst mallrat që prokurohen nga autoriteti juaj mund të shtypen dhe realizohen me një makineri me format minimal 22x31cm. Pra ky kriter i vendosur nga autoriteti juaj kontraktor nuk i shërben kësaj procedure prokurimi dhe është në tejkalim të kontratës që prokurohet dhe për më tepër është taksativ.

Në lidhje me formatin e makinerive ka dhe praktikë të institucionit më të lartë vendimmarrës në fushën e prokurimeve KPP-së më konkretisht venimi nr. 197/2017 datë 05.04.2017 që është dhënë për modifikimin e kriterëve [...]

Referuar sasisë dhe grafikut të lëvrimit sic dhe ju e keni shprehur formati maksimal është formati 21x29.7cm ky kriter nuk është proporcional me objektin e kontratës që prokurohet për pasojë duhet të modifikohet në përputhje me objektin e kontratës që prokurohet.

Referuar pretendimit të autoritetit kontraktor se Makineria “Shtypi offset me minimalisht 4 ngjyra dhe minimalisht format 50x70cm, (1 cope)” është vendosur duke u bazuar nga hulumtimi në internet të tipit të pajisjes së lartëpërmendur si dhe duke u mbështetur në procedura të ngjashme të realizuara me objektin e prokurimit. Format i kërkuar i makinerisë 50x70cm është vendosur në proporcion me natyrën dhe volumin e specifikimeve teknike të kërkuara më konkretisht: në specifikime janë kërkuar katër modele të ndryshëm formularësh, teknologjia e printimit të së cilave duhet të jetë shtyp offset dhe formati i letrës për makineri e këtij lloji kërkon dimension 50x70 cm (4 fletë në një tabak). Nisur kjo dhe nga afati i lëvrimit të mallit të përcaktuar në shtojcën 12 të dst-ve “Sasia dhe grafiku i lëvrimit”, prodhimi dhe furnizimi me dokumentacionin specifik (karta rezidenti) duhet të realizohet brenda 20(njëzet) ditëve nga momenti i nënshkrimit të kontratës, për një sasi prej 162.000 formularë. Formulari i makinerisë së pretenduar nga ana juaj 22x31cm

rezulton se i korresponon një pajisjeje të tipit printer dhe jo makineri. Shoqëria "Adel Co" shpk argumenton si më poshtë vijon:

Së pari autoritetet kontraktore në hartimin e keitereve të vecanta për kualifikim nuk duhet të bazohen vetëm në hulumtimet në internet, apo procedura të ngjashme me objektin e prokurimit, pasi në legjislacionin e prokurimit publik më konkretisht, referojmë në nenin 61 pika 2 e vkm-së 914 datë 29.12.2014 RrPP i ndryshuar [...].

Pra referuar bazës ligjore të mësipërme duket qartë që legjislatori nuk ka lënë vend për interpretim për këtë pikë në mënyrë që autoritet kontraktore mos të përfitojnë nga kompetencat e dhëna nga ligji gjatë prokurimit të fondeve publike. Në rastin e këtij kriteri të vendosur nga AK-ja duket qartë që këto kriteret nuk janë hartuar nga struktura të specializuara në fushën e objektit që prokurohet. Më konkretisht:

Në sasinë dhe grafikun e lëvrimit parashikohet që malli që prokurohet do të ketë format A4 dhe do të jetë në sasi 162.000 formularë. Karakteristikë e shtypshkronjave është që kanë makineri shtypi automatike të teknologjive të fundit. Sic edhe dihet këto makineri shtypin me një shpejtësi me minimumi 10.000 në orë. Duke marrë si referencë shpejtësinë minimale të shtypit sasia e prokuruar nga ak-ja (e llogaritur vetëm një fletë në një tabak) shtypet për vetëm 17 orë). Pra sic mund të konkludohet kërkesa e ak-së është në tejkalim të qëllimit të ak-së për realizimin me sukses të objektit të kontratës që prokurohet.

Në rastin konkret AK-ja mund të kërkojë edhe një makineri me format 35x52cm që lejon llogaritjen dhe shtypjen e 2 formularëve në një tabak dhe realizimi i gjithë procesit të shtypit për 9 orë.

Kriteri si më sipër i vendosur nga ak-a mbi formatin e makinerisë është joproporcional por edhe diskriminues, pasi ky kriter diskriminon dhe kufizon pjesmarrjen e biznesit të vogël në këtë procedurë prokurimi, parim ky i mbrojtur dhe i saksionuar nga LPP-ja.

Referojmë nenin 46 pika 3 [...]

Pra sa më sipër malli që prokurohet nga ak-ja mund të realizohet edhe me makineri të tjera që janë në proporcion me objektin e prokurimit dhe që garantojnë bazarizxë pjesmarrjen dhe konkurrencën në procedurën e prokurimit konkrete. Gjithashtu i njëjti argumentim është edhe për pikën d) të kriterit të mësipërm. Në kushtet që përmasat e kartës së rezidentit janë me diametër 8 cm, është në tejkalim të cdo parashikimi ligjor nga ana e ak-së përcaktimi në dst i një pajisjeje me formë prerje minimum 50x70cm. Për më tepër ky kriter duhet të hiqet nga ak-ja pasi me teknologjinë e ditëve të sotme, ku makineritë tashmë janë automatike dhe jo manuale procedura e prerjes me formë është një proces që është i inkorporuar në shumë makineri dhe bëhet sëbashku me procese të tjera pune njëherësh. Pra ky proces nuk është më një proces pune që kryhet në një makineri më vete, por është i inkorporuar dhe realizohet nga shumë makineri të tjera që mund të disponojë një operator ekonomik.

Pra ky kriter nuk është proporcional dhe nuk i shërben kontratës që prokurohet dhe për pasojë duhet të hiqet nga dokumentat e tenderit." Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” “Kapaciteti teknik” pika 2.3.5. të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

2.3.5. Ofertuesi duhet të ketë në dispozicion makinerite e meposhtme:

a) Shtypi offset me minimalisht 4 ngjyra dhe minimalisht format 50x70cm, (1 cope)

b) Pajisje përgatitore për shtyp CTP, (1 cope)

d) Pajisje prerje me forme me format minimal 50x70cm, (1 cope)

e) Pajisje për numerator dhe perforcim, (1 cope)

Per të vertetuar disponueshmerine e pajisjeve, ofertuesit duhet të paraqesin fature blerje ose kontrate qeraje të shoqëruar me faturen e blerjes.

III.1.2. Në shtojcën 1 “Sasia dhe Grafiku i Lëvrimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Karte Rezidenti	cope	162000

Afatet e lëvrimit: Prodhimi dhe furnizimi me dokumentacionin specifik (karta rezidenti) duhet të realizohet brenda 20 (njetzet) diteve nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

III.1.3. Në shtojcën 10 “Specifikimet Teknike” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Specifikimi i Materialeve:

Specifikimet teknike për imazhin fizik për kartat e rezidentit janë:

- Letër formulari: 90 gsm Laserbond
- Ngjyra formulari: 4 nga të dyja anët
- Ngjyra karta: 4 nga njëra anë
- Formati i formularit: A4
- Formati i Kartës: Diametër 80mm
- Numër serial: duhet të ketë një numër serial unik të paraprintuar për çdo formular dhe kartë.
- Materiali i kartes: Karta duhet të jetë e inkorporuar tek formulari si pjesë përbërëse e saj, si dhe të ketë plastifikim parcial. Karta duhet të jetë me prerje gjysëm presioni që të mund të hiqet lehtësisht nga formulari.
- Karta duhet të jetë adezive plastike, transparente, i cili mund të printohet dhe personalizohet në pajisjet printuese të Tirana Parking. Gjithashtu materiali i adezivit duhet të bëjë të mundur që

printimi i personalizuar të jetë rezistent ndaj gërvishtjeve dhe lagës me ujë. Karta adezive do të ngjitet në brendësi të xhamit.

- Elementë sigurie: Holograme e personalizuar 3D me logon zyrtare të Bashkisë.
- Të tjera: linjë perforimi.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma b të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të procurohen dhe jodiskriminuese."*

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor lidhur me këtë pikë të ankesës gjykon se autoriteti kontraktor e ka justifikuar dhe argumentuar nevojën në vendosjen e këtij kriteri. Konkretisht citoj: *"[...]Përsa më sipër kriteri i vendosur nga AK-ja është në mbështetje të legjislacionit të prokurimeve publike si dhe në proporcion me natyrën dhe objektin e procedurës së prokurimit. Kërkesa për makineri i shërben autoritetit kontraktor për të vërtetuar se oe-të kanë kapacitetin e nevojshëm për realizimin e kontratës. Në rastin konkret:*

Makineria "Shtypi offset me minimalisht 4 ngjyra dhe minimalisht format 50x70cm, (1 cope)" është vendosur duke u bazuar nga hulumtimi në internet të tipit të pajisjes së lartpërmendur si dhe duke u mbështetur në procedura të ngjashme të realizuara me objektin e prokurimit. Formati i kërkuar i makinerisë 50x70cm është vendosur në proporcion me natyrën dhe volumin e specifikimeve teknike të kërkuara më konkretisht: në specifikime janë kërkuar katër modele të ndryshëm formularësh, teknologjia e printimit të së cilave duhet të jetë shtyp offset dhe formati i letrës për makineri e këtij lloji kërkon dimesion 50x70 cm (4 fletë në një tabak). Nisur kjo dhe nga afati i lëvrimit të mallit të përcaktuar në shtojcën 12 të dst-ve "Sasia dhe grafiku i lëvrimit", prodhimi dhe furnizimi me dokumentacionin specifik (karta rezidenti) duhet të realizohet brenda 20(njëzet) ditëve nga momenti i nënshkrimit të kontratës, për një sasi prej 162.000 formularë. Formulari i makinerisë së pretenduar nga ana juaj 22x31cm rezulton se i korrespondon një pajisjeje të tipit printer dhe jo makineri[...]". Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri i mësipërm është në përputhje dhe proporcion me përmasat, kushtet volumin dhe afatin e ekzekutimit të kontratës.

Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues për vendime të tjera të Komisionit të Prokurimit Publik dhe konkretisht vendimi nr. 197/2017 datë 05.04.2017 ky i fundit sqaron se nuk ndodhemi në të njëjtat kushte dhe rrethanat e vendimit të sipërcituar, pasi specifikimet teknike të objektit të prokurimit në vendimin e mësipërm kishin përcaktuar në mënyrë strikte përmasat e mallrave objekt prokurimi. Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik gjykoi se ishte e panevojshme kërkesa e autoritetit kontraktor për një makineri me përmasa më të mëdha sesa formati

i objekteve (mallrave objekt prokurimi), ndërsa në rastin konkret Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se shfaqet nevoja e autoritetit kontraktor për të kërkuar makineri me përmasat e përcaktuara për shkak të mënyrës së printimit të këtyre formularëve dhe dokumentacionit specifik (karta e rezidentit), për shkak të shpejtësisë së procesit dhe afatit të shkurtër që do të realizohet kontrata, formularët nuk do të printohen një nga një, por katër njëherësh. Në këtë kuptim përmasat e makinerisë nuk mund të jenë në përmasat e formatit A4 sikundër pretendon ankimuesi por në përmasat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Adel Co” shpk shpk me argumentat se “ Në lidhje me pikën e) të këtij kriteri “Pajisje për numëror dhe përforcim, (1 cope)”, së pari theksojmë se edhe pas sqarimit të ak-së në përgjigjen e dërguar sërish është një kërkesë e paqartë dhe evazive. Bazuar në eksperiencën tonë shumë vjecare në këtë fushë ju bëjmë me dije se nuk ekziston makineri e vetme që të realizojë të dyja proceset pra numrator dhe përforcim.

Për më tepër AK-ja nuk ka sqaruar çfarë është pajisja për përforcim (apo perforim) dhe si i shërben kësaj procedure prokurimi pasi për oe-të potencialë për të marrë pjesë në këtë procedurë ky kriter është i paqartë dhe evaziv.

Referuar LPP-së, dst-ve duhet të jenë në gjuhën shqipe, duhet të jenë të qarta dhe lehtësisht të kuptueshme dhe nga personat me aftësi të kuafizuara. Edhe vetë ak-ja nuk di se çfarë është kjo makineri përforcimi dhe përse shërben për këtë procedurë prokurimi.

Nëse këto kritere do të ishin hartuar nga specialistë të fushës do të ishte e më e qartë për ak-në që nuk ekziston një makineri e vetme që të kryejë numëror dhe përforcim.

Kemi dyshime se ak-ja ka dashur të përcaktojë “Makineri perforimi”, termi në shqip për këtë makineri është për makineri për birosje. Edhe nëse ka qënë ky qëllimi i ak-së theksojmë se sërish kjo makineri nuk i shërben kësaj procedure prokurimi pasi asnjë element i mallit që prokurohet nuk është me birosje. Prerja e kartës do të bëhet në formë prerje dhe nuk ka vend për procesin e birosjes në asnjë prej proceseve të punës deri në realizimin e produktit përfundimtar.

Duke u bazuar në një analizë të thjeshtë të këtyre kritereve duket qartë se ak-ja ka shkelur haptazi përcaktimet ligjore, pasi njësia e prokurimit që ka hartuar këto kritere nuk ka informacion apo kapacitet për të hartuar kritere në fushën e objektit që prokurohet.

Nga një analizë që bëhet edhe nga një pëerson me njohuri mesatare duket qartë se këto makineri janë kërkuar nga AK-ja në shkelje të me ligjin.”Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” “Kapaciteti teknik” pika 2.3.5. të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

2.3.5. Ofertuesi duhet të ketë në dispozicion makinerite e mëposhtme:

a) Shtypi offset me minimalisht 4 ngjyra dhe minimalisht format 50x70cm, (1 cope)

b) Pajisje përgatitore për shtyp CTP, (1 cope)

d) Pajisje prerje me forme me format minimal 50x70cm, (1 cope)

e) Pajisje per numerator dhe perforcim, (1 cope)

Per te vertetuar disponueshmerine e pajisjeve, ofertuesit duhet te paraqesin fature blerje ose kontrate qeraje te shoqeruar me faturen e blerjes.

III.2.2. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor lidhur me këtë pikë të ankesës sqarohet se: *Për makinerinë “Pajisje per numerator dhe perforcim, (1 cope)” ju sqarojmë se për përmbushjen e këtij kriteri mund të paraqitet edhe një makineri për realizimin e këtyre dy proceseve: numëror dhe përforcim.. KPP gjykon se sqarimi i autoritetit kontraktor nuk është i qartë dhe i plotë. Autoriteti kontraktor ka detyrimin të sqarojë ofertuesit për cdo kriter në mënyrë të detajuar pasi emërtimi i saj ndikon drejtpërdrejt në mënyrën e ofertimit të operatorëve ekonomikë pjesmarrës. KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të bëjë sqarimet përkatëse lidhur me llojin e makinerisë që do të përdoret duke bërë njëherazi edhe publikimin e sqarimit përkatës në SPE në përputhje me nenin 42 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]*”*

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Adel Co” shpk shpk për modifikimin e kriterit me argumentat se “Gjithashtu në këtë pikë AK-ja ka përcaktuar se “Për të vërtetuar disponueshmërinë e pajisjeve, ofertuesit duhet të paraqesin faturë blerje kontratë qiraje të shoqëruar me faturën e blerjes”.

Ky kriter është taksativ dhe në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, pasi i kufizon oe-të potencialë për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi pasi në cdo rast ka përcaktuar që disponimi i këtyre makinerive të vërtetohet me anë të faturave të blerjes. Referuar legjislacionit të fushës ekonomike mardhëniet tregtare të subjekteve shqiptare mund të jenë brenda ose jashtë vendit. Pra një subjekt në rastin tonë një subjekt juridik mund të blejë mallra dhe shërbime si brenda ashtiu dhe jashtë vendit. Në rastin e blerjes së mallrave jashtë Shqipërisë dëshmia e blerjes së këtij malli është deklarata e zhdoganimit të mallit. Në kriterin e vendosur nga ana juaj duke qënë se nuk lini mundësi që oe-të të provojnë me anë të deklaratave të zhdoganimit disponimin e një malli ju diskriminoni në mënyrë direkte mallrat e blerë jashtë vendit. Në rastin e blerjes së mallrave jashtë Shqipërisë dhe kjo është në kundërshtim me frymën që përcjell LPP-ja.

Referuar pretendimit të ak-së që pajisjet e importuara shoqërohen gjithmonë me deklaratën doganore dhe faturën e blerjes së makinerisë theksojmë se fatura e lëshuar nga kompanitë e huaja për shitjen e një malli shërben për të zhdoganuar mallin në autoritetet doganore. Në rast se një subjekt tregon vetëm faturën e lëshuar nga një kompani e huaj, në asnjë rast nuk mund të vërtetohet nëse malli ka hyrë në shqipëri apo jo, pa paraqitur deklaratën e zhdoganimit të mallit nga subjekti. Përsa më sipër ky përcaktim duhet të modifikohet dhe të lejohet vërtetimi me anë të faturës së TVSH-së ose deklaratës së zhdoganimit.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” “Kapaciteti teknik” pika 2.3.5. të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

2.3.5. Ofertuesi duhet të ketë në dispozicion makinerite e meposhtme:

a) Shtypi offset me minimalisht 4 ngjyra dhe minimalisht format 50x70cm, (1 cope)

b) Pajisje përgatitore për shtyp CTP, (1 cope)

d) Pajisje prerje me forme me format minimal 50x70cm, (1 cope)

e) Pajisje për numerator dhe forcim, (1 cope)

Për të vërtetuar disponueshmërinë e pajisjeve, ofertuesit duhet të paraqesin faturë blerje ose kontratë qiraje të shoqëruar me faturën e blerjes.

III.3.3. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

III.3.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.3.5. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për “Për të vërtetuar disponueshmërinë e pajisjeve, ofertuesit duhet të paraqesin faturë blerje ose kontratë qiraje të shoqëruar me faturën e blerjes”, autoriteti kontraktor gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave duhet të mbajë parasysh dhe forma të tjera të provueshmërisë së disponimit të makinerive/mjeteve nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Adel Co” shpk shpk për “Referuar sa thamë më sipër lutemi gjithashtu që autoriteti kontraktor të marrë masat dhe të bëjë sqarimet e nevojshme me anë të një shtojce në dst për pikat të cilat na ka bërë sqarime në përgjigjen drejtuar shoqërisë sonë. Përsa më sipër ju lutem modifikimin e dokumentave standarte të tenderit në lidhje

me kriteret si më sipër pasi përcaktimi i tyre është bërë në kundërshtim me legjislacionin e Prokurimit Publik.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se referuar kthim përgjigjes Nr. 1353/3 prot datë 06.11.2017 të autoritetit kontraktor konkretisht citoj:

Arsyetimi për pretendimin e parë:

Ofertuesit duhet të paraqesin prane Autoritetit Kontraktor Tirana Parking, ne daten dhe oren e hapjes se ofertave, mostra te kartave te rezidentit, 8 (tetë) cope, ne perputhje me te gjitha specifikimet teknike ne DST, sipas formularit tip. Mosparaqitja e mostrave perben kusht s'kualifikimi.

Mostrat do të testohen në pajisjet e ndodhura ne ambjentet e Tirana Parking. Moskalimi me sukses i testimit është kusht s'kualifikues.

Kriteri i mësipërm është vendosur duke u bazuar në nenin 27 pika 6 gërma a) të VKM-së nr. 914 RrPP-së [...] Nenin 46 pika 1 e LPP-së [...]

Referur legjislacionit të mësipërm si dhe natyrës së kontratës publike objekt i procedurës së prokurimit objekt ankimi , përmban prodhimin e dokumentacionit specifik (Karta Rezident) për autoritetin kontraktor Tirana Parking. Paraqitje e mostrave i shërben Ak-së për të vlerësuar nëse një oe ka kapacite për të prodhuar produktin e kërkuar. Qëllimi i AK-së është furnizimi i produktit final për të cilën autoriteti ka kërkuar dorëzimin e mostrave.

Nisur nga specifikimet teknike të parashikuara në dst ku janë 4 imazhe që do të prodhohen për kartat e rezidentit operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë nga 8 (tëtë) copë mostra 2 (dy) mostra për imazh. Theksojmë se njëra prej mostrave do të shërbejë për testim në autoritetin kontraktor ndërsa mostra tjetër nevojitet për arkivim si dhe për cdo dëmtim të mundshëm gjatë testimit të kopjes së parë.

Gjithashtu përse i përket pretendimit tuaj se holograma si elementë përbërës i motrës duhet të jetë i ngjashëm dhe jo identik e konsiderojmë të drejtë për shkak të natyrës së produktit final të kërkuar nga autoriteti kontraktor e cila gëzon një mbrotje të vecantë pasi përmban elementë sigurie dhe ka nevojë për marrjen e një miratimi paraprak. Ju sqarojmë se ak-ja lejon paraqitjen e mostrave në përputhje me të gjitha specifikimet e tenderit me përjashtim të hologramës e cila do të jetë e ngjashme dhe përmbajtja e saj nuk do të përbëjë kusht skualifikimi. Dokumenti i kërkuar në rastin konkret karta e rezidentit do të pajisset me hologramë të personalizuar 3D me logon zyrtare të Bashkisë sikundër përcaktohet në specifikimet teknike në shtojcën 10 të dst-ve nga oe-ja i shpallur fitues dhe do të ekzekutojë kontratën. Vendosja e kërkesës së hologramës me logon zyrtare të Bashkisë në specifikimet teknike është bërë e qëllim që ofertuesit të përlllogarisin koston e saktë të produktit.

Arsyetimi për pretendimin e dytë:

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës pasi u njoh me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues arsyeton se :

Në shtojcën 10 të dst-ve “Kriteret e veçanta të kualifikimit” “Kapaciteti teknik” është kërkuar që ofruesit të paraqesin certifikat si më poshtë vijon:

certifikaten ISO 9001:2008 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, në përputhje me objektin e prokurimit, leshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim

certifikaten ISO 14001:2004 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit”, në përputhje me objektin e prokurimit, leshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

certifikaten ISO 14298:2013 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurtë të printimit”, në përputhje me objektin e prokurimit, leshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

Çertifikata kerkohet të jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.

Autoriteti kontraktor për vendosjen e kriterit të të mësipërm është mbështetur në nenin 46 pika 2 e LPP-së [...]dhe në vendimin nr. 914 RrPP-sëneni 300 pika 1[...]

Nëse i referohemi definicionit që ka secila prej certifikatave rezulton se certifikatat ISO të kërkuara janë në përputhje me objektin e prokurimit.

ISO 9001:2008 është standarti më i popullarizuar dhe më i përdorur në botë për sistemet e menaxhimit të cilësisë. Referuar objektit të prokurimit nevojitet që shoqëritë pjesëmarrëse të sigurojnë cilësi në ofrimin e shërbimeve dhe në kryerjen e kontratës. Theksojmë se ISO 9001:2008 është ekuivalente me ISO 9001:2015, konkretisht për “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë” oe-ja mund të paraqesë ISO 9001:2015, e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave duke mos përbërë kusht skualifikimi, duke qënë se certifikatat ISO janë vazhdimisht në proces rinovimi.

ISO 14001:2004 është standarti më i përdorur në botë për sistemet e menaxhimit të mjedisit. Prodhimi i dokumentacionit specifik (kartat e rezidentit), përveçse kërkojnë një kapacitet me makineri kanë edhe një ndikim në mjedis për shkak të kushteve në të cilat realizohen. Për këtë arsye cdo oeduhet të jetë i çertifikuar për menaxhimin e abjentit.

Theksojmë se ISO 14001:2004 është ekivalente me ISO 14001:2015, konkretisht për “Sistemet e menaxhimit të abjentit”, oe-ja mund të paraqesë ISO 14001:2015 e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave, duke mos përbërë kusht skualifikimi, duke qënë se certifikatat ISO janë vazhdimisht në proces rinovimi.

ISO 14298:2013 “Sistemet e menaxhimit të printimit”, është standarti më i përdorur për sistemet e menaxhimit të sigurtë të printimit, për të mundësuar realizimin cilësor të një produkti në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Theksojmë se dhe për certifikatën e sipërpërmendur mund të paraqitet ekivaletja e saj duke mos përbërë kusht skualifikimi, duke qënë se certifikatat ISO janë vazhdimisht në proces rinovimi.

Gjithashtu ju sqarojmë se certifikatat ndërkombëtare ISO të lëshuara nga organe të akredituara pasqyrohet objekti i ushtrimit të aktivitetit të subjektit ofertues, sipas QKR-së. Nëse organe të ndryshme të akreditimi , përdorin mënyra të ndryshme të formulimit të certifikatës kjo nu sjell probleme në vlerësim nga ana jonë.

Ankimuesi është sqaruar nga ana e autoritetit kontraktor për disa nga pikat e ankesës së tij, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të bëjë publikimin e sqarimeve përkatës në SPE në përputhje me nenin 42 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: Ofertuesi i mundshëm mund të

kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]"

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendosi

1. Të pranojë pjeserisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Adel CO" sh.p.k për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur" me Nr.REF-31551-10-26-2017, me objekt : "Prodhim të dokumentacionit specifik (karta rezidenti)", me fond limit 10,335,600 lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar më datë 20.11.2017 nga autoriteti kontraktor, Tirana Parking.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentat e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues "Adel CO" sh.p.k
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1703 Protokoli, Datë 15.11.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha